

**VENDIM**  
**Nr. 121, datë 22.2.2012**

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 469, DATË 16.6.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR PROCEDURËN E SHQYRTIMIT TË ANKESAVE NDAJ PROCEDURAVE TË KONCESIONIT APO TË VENDIMEVE PËR PËRJASHTIM NGA KËTO PROCEDURA” DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 27, DATË 19.1.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË VLERËSIMIT DHE TË DHËNIES SË KONCESIONEVE””, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 24/1 të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në tekstin e rregullores bashkëlidhur vendimit nr. 469, datë 16.6.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pas nenit 2 “Përkufizime”, të kreut I, shtohet neni 2/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 2/1

**Baza juridike për funksionimin dhe veprimtarinë e komisionit**

Komisioni i Prokurimit Publik funksionon dhe ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Kushtetutën, me ligjin nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, me ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, me aktet e tjera, ligjore dhe nënligjore, si dhe me këtë rregullore.”.

2. Neni 8 “Rregulla të përgjithshme procedurale”, i kreut II, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 8

**Rregulla të përgjithshme**

1. Për çdo çështje të ankimuar, kryetari apo, në mungesë të tij, zëvendëskryetari, cakton me short si relator tre nga anëtarët, duke siguruar shpërndarjen e barabartë të çështjeve ndërmjet tyre. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, në rast se ka mendime të ndryshme ndërmjet relatorëve, projektvendimi hartohet sipas mendimit të shumicës së tyre.

2. Rregullat për njohjen me aktet, përjashtimin e kryetarit, anëtarëve, inspektorëve, ekspertëve dhe specialistëve të pavarur, në kushtet kur gjenden në një nga rastet e konfliktit të interesit, si dhe për pjesëmarrjen dhe detyrat e inspektorëve në shqyrtimin e një ankimi sipas ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006, janë të njëjta me ato të përcaktuara në rregulloren e prokurimit publik.”.

3. Në pikën 1 të nenit 14 “Përmbajtja e vendimit”, të kreut II, pas fjalëve “... vulën e Komisionit ...” shtohen fjalët “... anëtarët e pranishëm në mbledhje, relatorin e çështjes, votimi kundër ...” dhe pas fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Gjithashtu, çdo anëtar ka të drejtë të kërkojë që arsyetimi i mendimit kundër ose konkurrues t’i bashkëlidhet vendimit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**